




## KOMUNA E NOVOBËRDËS



Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika b. të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Nr.03/Z-040), nenit 17 për menaxhimin dhe përgjegjësinë në punën e financave publike (Nr.03/Z-048), neneve 7 dhe 12 të Udhëzimit MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, kryetari i Komunës së Novobërdës, më 15.08.2025, nxjerr këtë vendim:

### VENDIM

Për publikimin e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet/programet e organizatave joqeveritare në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

#### I

1. Për zbatimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Udhëzimit MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja publike për projektet/programet e organizatave joqeveritare do të sigurohet nga buxheti i Komunës së Novobërdës – kodi 654, kodi ekonomik i subvencioneve 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 160/16030.

#### II

1. Mjetet e përmendura në nenin e dhënë do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, në bazë të dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, i cili përbën pjesë përbërëse të këtij vendimi.

#### III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes, sipas pikës II të këtij vendimi, përfshin:
  1. Teksti i thirrjes publike
  2. Udhëzimet për kandidatët
  3. Formularët për aplikim
  4. Formulari për vlerësimin e cilësisë së projekteve
  5. Formulari për raportimin mbi realizimin e projektit
2. Formularët për aplikim të cilët janë përmendur në paragrafin 1 të këtij neni:
  1. Formulari për përshkrimin e programit ose projektit
  2. Formulari për buxhetin e programit ose projektit
  3. Formulari i deklaratës për mos-ekzistimin e financimit të dyfishtë të aktiviteteve nga burime të tjera.
  4. Deklarata e partneritetit (nëse zbatohet).
  5. Formulari i deklaratës për programet dhe projektet e OJQ-ve që janë financuar nga burime publike.
  6. Deklarata e zbatuesve të aktiviteteve të përmendura në përshkrimin e projektit se janë të njohur me programin ose projektin dhe për pjesëmarrjen e tyre në zbatim (nëse është e nevojshme).

Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni përfshijnë:

1. Formulari i kontratës për financimin e programit ose projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin ose programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar për projektin ose programin

#### IV.

Ftesa publike dhe dokumentacioni për realizimin e ftesës do të publikohen të plota në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare. <https://kk.rks-gov.net/novoberde/sr/>

#### V.

1. Në përputhje me Rregulloren mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzimet për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare shtetërore do të krijojë një Komision Vlerësimi për hapjen dhe regjistrimin e aplikimeve dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara nga thirrja publike.
2. Komisioni për vlerësim do të vlerësojë përmbajtjen e aplikimeve të pranuar të projekteve që kanë plotësuar me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit për vlerësim do të punojnë në përputhje me procedurën e paraparë në Udhëzimet për aplikantët dhe rregullat e përcaktuara me Udhëzimin MF-Nr-04/2017 për financimin publik të OJQ-ve.

#### VI.

1. Pas marrjes së vendimit për kandidatët e suksesshëm, projektet e të cilëve plotësojnë kushtet për financim, drejtuesi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programve të OJQ-ve.
2. Komuna e Novobërdës do ta njoftojë përfituesin për kohën e nënshkrimit të kontratës.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe kabineti i kryetarit.

#### IX.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet:

Kabinetit të kryetarit të komunës,  
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave,  
Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme,  
Arkivit.

Kryetari i Komunës

Saša Milošević

